

NOPRANET nga Sasha Dugdale

Tri plaka kumarxhesha

Zhurma e letrave të bixhozit që shpërndahen mbi tavolinë. Britma: ooh! hë?! dhe fërshëllima mes dhëmbëve, teksa tensioni shtohet.

GRUAJA 1. *(përplas një letër përdhe)*. Çupë spathi. Pa, hajt, tundini stolitë, motrani.

GRUAJA 2 *(duke u qaravitur)*. Hë, se i fitoj prapë.

GRUAJA 1. S'duhet t'i kishe vënë bast.

GRUAJA 2. Hë, se çikërrima dylekëshe janë.

GRUAJA 1. Më pëlqeka kjo. Oniks?

GRUAJA 2. Po, kishin vlerë shpirtërore.

GRUAJA 1. Oniks *(pauzë)* oniksoniksoniks.

GRUAJA 2. Ma kishin dhuruar.

GRUAJA 1. Më rri fiks te gishtit i madh.

GRUAJA 2. Shumë grua e ligë je.

GRUAJA 3. Domosdo, prandaj është kështu qyqare.

GRUAJA 1. Qyqare me vetminë time. *(i vështron me inat)*. Unë dhe unaza ime e oniksit. Nuk kam burrë që të ma dredhë.

GRUAJA 2. Si sëpata pa bisht.

GRUAJA 3. Unë ndaj?

GRUAJA 1. *(me zë të lartë)* Po.

GRUAJA 3. Në rregull, e mora vesh, se nuk jam shurdhe.

Ngatërrohet me aparatit e dëgjimit, dëgjohej zukama e tij prej mushkonje, ndërsa e rregullon.

E mori dreqi këtë gjësend elektrik! Më mirë ato buritë e veshit.

GRUAJA 1. Kjo ka rrjedhur.

GRUAJA 3 *(ende jep e merr me pajisjen)*. Nuk kam as edhe një tingull në kokë dhe bota shuhet fare. Si plaku yt, hë?

GRUAJA 1. Ai ra si trung, as u përkul, as u rrokullis, asgjë.

GRUAJA 2. Do ta fusësh unazën e zezë prapë në lojë për mua? E kisha për zemër.

GRUAJA 1. Edhe unë për zemër e kam. Do vë këtë.

Tingulli i një ore të lirë digjitale.

GRUAJA 3. Punon?

GRUAJA 1. Është orë e mirë.

GRUAJA 3. Po kohën e mat saktë?

GRUAJA 2. Një mut është, ja ç'është. Vër në tryezë unazën time.

GRUAJA 1. S'është më jotja. S'është më unaza jote.

GRUAJA 3. Gjithmonë e kam dashur një orë digjitale. Si ato të terroristëve.

GRUAJA 2. Të terroristëve? Ku merr vesh nga terroristët ti?

GRUAJA 3. Ata kanë ora digjitale.

GRUAJA 2. Mos ke ndonjë bombë në çantë?

GRUAJA 3. Kam një gjë më të mirë se bomba.

Zhurma e tapës së një shisheje që zhvidhohet dhe mbushja e gotave. I trokasin gotat.

GRUAJA 1 (*pi dhe përplas buzët*). Bum!

GRUAJA 2. (*e pështyn atë që sapo piu*). Ç'dreqin është kjo?

GRUAJA 3. Receta e mamit. Me këtë fillon sheh gjëra.

GRUAJA 2. E fortë shumë.

GRUAJA 1. Të hap një sy të tretë mu në mes të ballit.

GRUAJA 2 (*kollitet*). M'u ndez fyti.

GRUAJA 1. Bëjmë dhe një dorë?

GRUAJA 3. Luajte bixhoz me djallin, i vure sipër tët shoq dhe humbe. (*pauzë*) Apo mos fitove, e dashura ime?

GRUAJA 1. Po mbase edhe fitova.

GRUAJA 3. Ia vlejti çlirimi?

GRUAJA 1. Ma dridhte me një kuçkë. M'i blinte gjëra asaj. Me paratë e mia.

GRUAJA 2. Vëre unazën në lojë.

GRUAJA 1. Oniksoniksoniksin?

GRUAJA 2. Të lutem.

GRUAJA 3. Hajt tani, jepja mundësinë ta fitojë prapë.

GRUAJA 1. Të shohim ndonjë gjë të hairit, që t'ia vlejë edhe munda i lojës.

GRUAJA 3. Që t'ia vlejë munda i lojës. (*zukama prej mushkonje e aparatit të dëgjimit, me të cilin jep e merr, derisa e heq fare*)

GRUAJA 1. Iii. (*me zë të lartë*) E kishe në vesh. Është gjithë dyllë. As nuk është ftohur akoma.

GRUAJA 3. S'dëgjoj hiç pa të. Po e fitove, flake në liqen.

GRUAJA 1. Do ta flak, që ç'ke me të. Ç'është kjo letër e katranosur?

GRUAJA 2. Një letër e fshehtë.

GRUAJA 3. Nuk duhet...

GRUAJA 1. Ndonjë gjë të hairit, tha.

GRUAJA 3. Po, po ka të hairit e të...

GRUAJA 1. Kush e ka shkruar? Pa nëma këtu!

GRUAJA 2 i qëllon duart.

GRUAJA 2. Jo, mos!

GRUAJA 1. Oh! Më pëlqejnë misteret.

Fillojnë të luajnë.

GRUAJA 3. S'duhet të isha fare këtu.

GRUAJA 1. A do sajoje gjëra që të takoheshin sa më shumë njerëz?

GRUAJA 3. Po është kundër rregullave.

GRUAJA 2. Çfarë? Bixhozi?

GRUAJA 3. Grindanjozi?

GRUAJA 1. (*Me zë të lartë*) BIXHOZI? Thua se është Las Vegas këtu. Shiko rrotull. Një hale e ngushtë ku dhjesin pulat.

GRUAJA 3. Për koronën po them. Ne të tria mbyllur brenda.

GRUAJA 1. Korona Futja-kot-ona. Unë më parë do vdes nga lagështia, se nga korona. Po hajt, se iku tani.

GRUAJA 2. E bëre vaksinën ti?

GRUAJA 1. Sigurisht, vogëlushja ime.

GRUAJA 2. (*Me zë më të lartë*). Po ti?

GRUAJA 3. Jo, as që bëhet fjalë. 5G, hë? Na vjen nga këto shtyllat e telefonave.

GRUAJA 1. Hajt me këto edhe ti, këtu as që ka sinjal. Përfundova deri te vatha e kuajve atje sipër, që të merjta në telefon bastvënësit. Vetëm aty kapa një vijë vale.

GRUAJA 3. Për kë vure?

GRUAJA 2. Po vura ca javën e shkuar për Lulen e Pafajshme.

GRUAJA 1. Shiko me kujdes atë Fluturo, Fluturo, Fluturo, se ka një të vrapuar!

GRUAJA 3. Nuk do përfundojë mirë ai.

GRUAJA 1. Vath në vesh do ta mbaj këtë.

Ka një pauzë ndërsa luajnë.

Pra... (*shkujdesur*) si është puna e kësaj letrës, e dashur?

GRUAJA 2. Mos më huto.

GRUAJA 1. S'po të hutoj.

GRUAJA 2. Po më ngatërron, pra.

GRUAJA 1 (*turivarur*). Pse je kaq e mbrapshtë?

GRUAJA 2. Të paktën, s'kam vrarë burrin.

GRUAJA 1. Po unë s'e vrava... ama të vdekur e doja, se një copë bishtpërdredhuri ishte.

GRUAJA 2. Po e the para kësaj Baba Jagës¹ këtu, apo jo?

¹ Baba Jaga është një krijesë e mbinatyrshe e folklorit të Evropës Lindore, me pamje prej shtrige, por që perceptohet në shumë mënyra të ndryshme, si re, hënë, vdekja, dimri, gjarpër, zog, pelikan, perëndeshë e Tokës, totem i paraardhëseve të matriarkatit, zanafilla e grave ose nëna e mashkullit.

GRUAJA 1. Ku dëgjon kjo. E hoqi pajisjen, ja.

GRUAJA 3. Me kë e ke “kjo” ti? Kush jam unë?

GRUAJA 2. *(me zë më të lartë)*. Ti ia hëngre kokën burrit të kësaj?

GRUAJA 3. *(si duke bërë bisht)*. S’duhet të kishte hipur në shkallë në mes të stuhisë.

GRUAJA 2. Ç’donte në shkallë atë natë?

GRUAJA 1. I thashë që kishte mbetur macja në çati.

GRUAJA 2. Kishte mbetur vërtet?

GRUAJA 1. Ku kishim mace ne!

GRUAJA 3 *(përplas letrat në tavolinë)*. Shikoni! Fitova! Ja, e nxori kokën prapë! Çupa spathi! Po është imja këtë herë *(puth letrën)* Pa bjerini këtu gjithë xhevahiret tuaja! *(troket me gishtërinj në tryezë një marsh fitoreje të luajtur me daulle)* Sa ma kishte qejfi një unazë oniksi! E zezë pis! Siç kam zemrën.

GRUAJA 1. Shët! *(me zë më të lartë, sikur po shpall lajm)* Zër vend aty se nuk ke fituar.

GRUAJA 3 *(me dyshim)*. Nuk të dëgjoj.

GRUAJA 1. Nuk ke fituar. Shiko, kam shtatë maçe në dorë. I shikon?

GRUAJA 3. Prapë s’të dëgjoj.

GRUAJA 1. PSE S’E VË APARATIN E DËGJIMIT? Di unë si të ta shkël nga veshi po ta fitova.

GRUAJA 3. Mirë, në rregull.

Vazhdojnë lojën.

GRUAJA 3. Zëre se na ka plasur lufta.

GRUAJA 2. Hë?

GRUAJA 3. Mbajeni mend ç’po ju them. Po një derr lufte, ama. Nga ato prej vërteti. Si ajo ku ka qenë gjyshi. Po zien nën sipërfaqe. Si fole milingonash që nxitojnë nga të katër anët dhe e bëjnë tokën plot me kanale të ngushta e guva, aq sa dheu fillon të shkërmoqet, Nëse mban vesh, arrin edhe ta dëgjosh. Pastaj, një ditë, hop: toka s’mbahet dot më, ndërtesat fillojnë gërryhen dhe as vetë nuk e merr vesh se si i hedhin trutë në erë njëri-tjetrit.

GRUAJA 2. Cilat? Milingonat?

GRUAJA 3. Njerëzit.

GRUAJA 1 (*edhe më fort*). E si dreqin dëgjuake milingonat e luftës, kur nuk na dëgjon ne?

GRUAJA 3. E shoh. Të trazon zorrët. Ngrihet tymi si re që përdridhen. Fushat janë gjithë gropa. Shkretë gjithandej, kurse jetët dergjen mbi to si gruri i thatësirës.

GRUAJA 1. Na i kurse, zemër, se na shtive mërzinë. Sikur të rrimë te garat?

GRUAJA 3. Oqeani i Neptunit. Në Njubëri² 6 me 1.

GRUAJA 2. (*papritmas*). A mund të ma kthesh letrën time?

GRUAJA 1. Sigurisht që jo.

GRUAJA 2. Kam një karficë. Na! Po sikur të vë këtë?

GRUAJA 1. Nuk ndryshohet plaçka e bastit, zemër.

GRUAJA 2. Shikojë! Një kukuvajkë e vogël, e shëh? Ku ku, ku ku,... (*tingulli shkon e meket*)

Pauzë

GRUAJA 1. Po pse e vure në lojë?

GRUAJA 2. Se doja unazën time! Se... Po ti po fiton rresht!

GRUAJA 1. Më trego dorën.

Heshjë

GRUAJA 2. Jo... më jep një tjetër mundësi ...

GRUAJA 1. S'funksionon ashtu. Kjo është me hile!

GRUAJA 2. E di, e di, po vetëm këtë herë. U tregova fare budallaçkë.

GRUAJA 1. Nuk luhet, nëse njëra prej nesh bën me hile.

GRUAJA 2. Po më pëlqen! Po ti! Edhe ti po thua që po bëj me hile?

GRUAJA 3. Fillojmë nga e para. Ndaji prapë.

GRUAJA 1. Mirë, do t'i ndaj prapë. Po vetëm nëse bie dakord, që kush fiton, e lexon.

Tingulli i letrave që shpërndahen, disa prej tyre i tërheqin.

GRUAJA 2. Filloj unë (*e hedh një letër dhe fillojnë lojën*).

GRUAJA 1. Poooo.

² Pista e vrapimeve me kuaj të Njubërit gjendet në qytetin me të njëjtin emër të Britanisë së Madhe dhe atje zhvillohet një garë e përvitshme me kuaj.

GRUAJA 2. *(i hap letrat në tryezë). Ç'bëj kështu dhe unë!*

GRUAJA 1. Poooo, e dija...

GRUAJA 3 *(përplas letrat përdhe, e ndërpret GRUAN 1). Mbret kupë! Pa shiko! Kupat fitojnë! Ma jep letrën.*

GRUAJA 1. E pabesueshme.

GRUAJA 3. Më sheshit se kaq!

GRUAJA 1. Ke yshtur letrat?

GRUAJA 3. Po s'fiton vetëm ti.

GRUAJA 2. *(në ankth).* Ç'do bësh me letrën?

GRUAJA 3. Do ta djeg, zemër. Ashtu siç duhet ta kishe djegur edhe ti.

GRUAJA 2. Jo...

GRUAJA 1. Lexoje njëherë. Lexoje me zë të lartë!

GRUAJA 2. S'mund ta...

GRUAJA 1. Nëma...

GRUAJA 2. Prit...

GRUAJA 1. Imja...

GRUAJA 3. E asnjërës!

GRUAJA 3 ndez një fije shkrepëse.

Heshtje ndërsa letra digjet.

Një kukuvajkë kalon pranë, duke kënduar me zë të ulët.